



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1640/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përbarimore të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës (TEIP), me seli ne rr.”Qamil Hoxha” Prishtinë, ndaj debitorit “KEDS” sh.a, me nr. Unik Identifikues 810799364, me seli ne Prishtinë rr.”Bill Clinton” p.nr, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2571/22 dt.27.09.2023, me datën 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “KEDS” sh.a, me nr. Unik Identifikues 810799364, me seli ne Prishtinë rr.”Bill Clinton” p.nr, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2571/22 i datës 27.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2571/22 dt.27.09.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit KEDS” sh.a, me nr. Unik Identifikues 810799364, me seli ne Prishtinë rr.”Bill Clinton” p.nr, dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përbarimor P.nr.175/22 dt.14.11.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Driton Govori.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përbarimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, urdhrin përbarimor ta anuloj dhe të obligohet kreditori që ti bart shpenzimet përbarimore ne tërësi.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës (TEIP), me seli në rr. "Qamil Hoxha" Prishtinë, me datën 14.11.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit "KEDS" sh.a, me nr. Unik Identifikues 810799364, me seli në Prishtinë rr. "Bill Klinton" p.nr, në bazë të dokumentit përmbarimor - Vendimit 01 nr.09-168/2021 i datës 18.01.2022 i formës së prerë dhe ekzekutueshëm nga data 10.10.2022, i lëshuar nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Përmbaruesi Privat Driton Govcorig në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.175/22 dt.14.11.2022, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të masës ndëshkuese - gjobës, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 2,000.00 euro, si edhe shpenzimet e përmbaruesit.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se e kundërshton në tërësi urdhrin përmbarimor sepse debitori nuk i është dhënë mundësia e përmbushjes vullnetare të gjobës, shton se debitori KEDS vendimin e shkallës së parë e ka pranuar me datën 09.11.2022 kurse kreditori ka iniciuar procedurën përmbarimore pa u konsumuar koha e përmbushjes vullnetare e borxhit, andaj propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor të anulohet dhe ta obligoj kreditorin të bartë shpenzimet përmbarimore.

Përgjigje në prapësimin e debitorit, ka ushtruar kreditori, me arsyetimin se i kundërshton thëniet e debitorit në prapësim sepse inspektorët e punës i kanë zbatuar dispozitat ligjore si dhe drejtë e kanë konstatuar gjendjen faktike, vendimet e TEIP janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndal ekzekutimin e vendimit, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbarimor.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.2571/22 dt.27.09.2023, me të cilin ka vendosur definitivisht si në dispozitiv të aktvendimit. Arsyeton se vendimi 01 nr.09-168/2021 i datës 18.01.2022, mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi është konform nenit 22 par.1 nën par.1.2 të LPP dhe është dokument përmbarues dhe i njëjti përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 27 par.1 të LPP, po ashtu gjykata i referohet edhe nenit 36 par.1 të LPP duke përcaktuar se vendimi është bërë i ekzekutueshëm dhe i formës së prerë me datën 10.10.2022. Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit se nuk i është dhënë mundësia që detyrimin ta përmbush në mënyrë vullnetare por se vlerësoi se debitori ka qenë i njoftuar për pagesën e detyrimit që nga marrja e vendimit dhe se ankesa në kuptim të nenit 6.4 të Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës nuk e ka shtyrë ekzekutimin e vendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është

caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori. Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi 01 nr.09-168/2021 i dates 18.01.2022, i lëshuar nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3, e po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi 01 nr.09-168/2021 i dates 18.01.2022 është dokument i përmbarueshëm dhe cilësia e tillë i është vërtetuar me faktin se i njëjti është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 10.10.2022, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “*Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim, andaj kjo gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit se nuk i është dhënë mundësia për ta paguar detyrimin në mënyrë vullnetare sepse vendimin e shkallës së dytë të Organit Administrativ e ka pranuar me datën 09.11.2022 ndërsa kreditori e ka iniciuar procedurën e përmbarimit me datën 14.11.2022, mirëpo këtë pretendim e vlerësoi si të pabazuar sepse debitori ka qenë në njohuri për detyrimin e tij me pranimin e vendimit 01 nr.09-168/2021 i dates 18.01.2022 nga TEIP. Kjo gjykatë analizoi edhe pretendimet tjera por i vlerësoi si jo relevante për një vendosje ndryshe, andaj të njëjtat i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1640/23, me datë 13.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha